



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRRIË

**Raporti nga dëgjimi buxhetor i organizuar nga Kryesuesja e Kuvendit për
projekt buxhetin e komunës për vitin 2024**

Shtator 2023

Hyrje

Buxheti i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2024 është 26 milionë e 770 mijë e 39 euro dhe është i ndarë në kategori si: investime kapitale 6,926,738.00, paga dhe mëditje 13,209,301.00, mallra dhe shërbime 4,840,000.00, shpenzime komunale 571,000.00, si dhe subvencione dhe transfere 1,223,000.00.

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna me theks neni 5. Zbatimi i standardeve të konsultimit publik dhe neni 17. Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Në këtë raport mund të gjeni të dhëna nga dëgjimi buxhetor i organizuar nga Kryesuesja e Kuvendit, në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, mënyrën e marrjes së kërkesës nga ana e qytetarëve, në formë fizike, elektronike dhe në takimin direkt të mbajtur në lokalitet.

Ftesa për mbajtjen e dëgjimit buxhetor është publikuar me datë 06 shtator 2023 në uebfaqen e Komunës së Vushtrrisë:

<https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2023/09/Konsultim-publik-per-projekt-buxhetin-e-Komunes-se-Vushtrrise-per-vitin-2024.pdf>

Në rrjetin social facebook:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=638141141781022&set=a.256978853230588>

Në platformën e konsultimeve publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42045>

Me datë 13.09.2023 është publikuar procesverbali nga dëgjimi publik për buxhetin e vitit 2024 në uebfaqen e Komunës së Vushtrrisë në versionin SCAN, PDF dhe WORD.

<https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2023/09/Procesverbal-nga-degjimi-buxhetor-per-buxhetin-e-vitit-2024-organizuar-nga-kryesuesja-e-Kuvendit-11.09.2023-SCAN.pdf>

Pas mbajtjes së dëgjimit publik, në ueb faqe të Komunës së Vushtrrisë është publikuar edhe lajmi për mbajtjen e dëgjimit publik për buxhetin e vitit 2024.

<https://kk.rks-gov.net/vushtrri/news/mbahet-degjim-publik-me-qytetare-per-buxhetin-e-vitit-2024/>

Tabela me të dhëna të përgjithshme për numrin e pjesëmarrësve dhe numrin e kërkesave të pranuar.

Metoda e konsultimit	Data	Numri i pjesëmarrësve			Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa/sugjerime	Numri i kërkesave të pranuar
1-Takim i drejtpërdrejtë mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës	11.09.2023	F	M	T	13	30
		12	11	23		
2-Kërkesa në formë elektronike	11.09.2023	F	M	T	8	39
		1	7	8		
		Totali i pjesëmarrësve:			Totali i qytetarëve që kanë dhënë komente, kërkesa/sugjerime:	Totali i kërkesave:
		F	M	T		
		13	18	31	21	69

Kërkesat e parashtruara nga ana e qytetarëve në dëgjimin publik, por edhe të dorëzuara në mënyrë elektronike, janë shqyrtuar nga Grupi Punues, dhe janë paraqitur në shtojcën nr.1 të këtij raporti.

Shtojca-Tabela e detajuar me informata për kërkesat e dhëna

Nr.	Kërkesat/Sugjerimet/Komentet	Kush ka dhënë kërkesë/sugjerim për projekt buxhetin e vitit 2024
Dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2024 organizuar nga kryesuesja e Kuvendit		
1	1. Zgjidhja e çështjes së pronësisë së pronës së shkollës “Ali Kelmendi” 2. Renovimi i objektit përcjellës të shkollës “Ali Kelmendi”	Milazim Hyseni, drejtor i shkollës “Ali Kelmendi”

	3. Ndërtimi i një salle sportive për shkollën “Ali Kelmendi”	
2	1. Asfaltimi i rrugës “Kërçova”	Arben Beka, përfaqësues i lagjes Kërçova
3	1. Renovimi i tërësishëm i objektit të Shoqatave të dala nga lufta 2. Të bëhet rregullimi i pjesës së mbetur të varrezave dhe të bëhen varret e njëjta për të gjithë martirët në varrezat “2 Maji”	Vildane Mulaku, kryetare e Shoqatës së Martirëve të Lirisë
4	1. Ndërtimi i stacionit të autobusëve në Vushtrri 2. Riciklimi i mbeturinave 3. Projekte për punësim-Start-UP 4. Të ndriçohen varrezat e dëshmorëve të UÇK-së	Sevdije Sadiku, banore e Vushtrrisë
5	1. Renovimi i tërësishëm i objektit të Shoqatave të dala nga lufta 2. Subvencionim të shoqatave të grave për trajnime dhe ligjërime për vetëdijesimin për sëmundje të ndryshme	Fikrije Ferizi, drejtoreshë e Organizatës së Gruas “ATO”
6	1. Zgjidhja e problemit të ujit të pijes për fshatin Stanoc i Epërm 2. Zgjidhja e problemit të ujit të pijes dhe shtrirja e kanalizimit në fshatin Gracë	Fehmi Shala, kryetar i Këshillit Lokal Stanoc i Epërm
7	1. Furnizimi me ujë të pijes për fshatin Samadrexhë 2. Hapja e rrugës tek varrezat e fshatit, 450m 3. Pastrimi i përroskave të fshatit Samadrexhë	Muhamet Rashani, përfaqësues i fshatit Samadrexhë
8	1. Renovimi i sallës sportive në fshatin Samadrexhë 2. Të bëhet një qendër e zjarrfikësve në Samadrexhë 3. Shtrirja e rrjetit të kanalizimit për fshatin Samadrexhë 4. Vendosja e shtatores së Heroit Lumni Surdulli tek rrethi i INTEREX	Lulzim Surdulli, nga fshati Samadrexhë
9	1. Subvencionimi me kultivatorë për gratë e fshatit Oshlan 2. Sigurimi i një objekti për mbajtje të mbledhjeve të grave të fshatit Oshlan	Sabile Gjaka, kryetare e grave të fshatit Oshlan
10	1. Ndarja e një fondi të veçantë për një pushim 5 ditor për fëmijët me Doën Syndrome	Shukrije Krasniqi, përfaqësuese e shoqatës Doën Syndrome
11	1. Ndriçimi i rrugës Druar-Reznik 2. Zgjidhja e çështjes së shkollës së vjetër në fshatin Druar që ka mbetur gjysmë e rrënuar 3. Renovimi i fushës së sportit në shkollën e fshatit 4. Në fshatin Mihaliq tek lagja Sylja të hapet rruga	Xhemajl Bojku, përfaqësues i fshatit Druar

12	1. Ka dorëzuar kërkesë me shkrim për fshatin Stanoc i Poshtëm dhe Lumadh	Hysni Bekteshi, nga fshati Stanoc i Poshtëm
13	1. Zgjidhja e çështjes së ujësjellësit, kanalizimit, asfaltim i rrugëve dhe ndriçimi i rrugëve	Rrahim Parduzi, banor i Vushtrrisë
Kërkesat e dorëzuar online		
14	1. Ndarja e buxhetit për shënimin e 100 vjetorit të rënies së Azem Bejtë Galicës 2. Vendosija e shtatores së Azem dhe Shote Galicës në Vushtri	Qamil Sahiti, nga Vushtrria
15	1. Asfaltimi i rrugës “Ura e gurit” 500m	Tahir Musliu, banor i fshatit Maxhunaj
16	1. Vendosija e shtatores së heroit Lumni Surdulli në Vushtri	Muhamet Rashani, kryetar i Këshillit Lokal Samadrexhë
17	1. Rregullimi i urës në fshatin Stanoc i Epërm	Sabri Haradinaj, nga fshati Stanoc i Epërm
18	1. Të ndahet një fond i veçantë për të organizuar një pushim për fëmijët me sindromën down	Shemsije Maloku, përfaqësuese e fëmijëve me sindromën down në Vushtri
19	1. Rregullimi i trotuarit në rrugën “Sadik Mala” në Gracë me gjatësi 300m 2. Ndërtimi i një ankesi në SHFMU “Nazmi Zhegrova” në Stanoc të Poshtëm pasi ka shtim të numrit të nxënësve 3. Ish-objekti i SHFMU “Migjeni” të bëhet çerdhe	Faton Hyseni, banor i fshatit Stanoc i Epërm
20	Kërkesat për fshatin Stanoc i Poshtëm: 1. Asfaltimi i rrugëve lokale 3000 metra gjatësi 2. Rrugë të rendit të 4-të 6000 metra gjatësi 3. Trotuar 2000 metra gjatësi dhe shtegu i biçikletave 4. Ndërtimi i urës në lagjen e Duraku, 5. Kanalizim 2500 metra gjatësi, 6. Ndriçim publik 1200 metra gjatësi (apo 50 drita) 7. Intervenim të shpejtë në stafin e shkollës ku nuk mbahen orët mësimore me rregull nga arsimtarët dhe ndërrimi i menjëhershëm i menaxhmentit të shkollës 8. Shtimi i një aneksi të shkollës, pasi që çdo vit po rritet numri i nxënësve të shkollës në fshatin tonë 9. Rregullimi i dy fushave sportive, njëra në lagjen e Prekazi dhe tjetra tek shkolla, 10. Rregullimi i çerdes për fëmijët	Rrahim Ajeti, kryetar i Këshillit Lokal Stanoc i Poshtëm-Lumadh

	11. Rregullimi i një parku tek “Ledina e ulët” Kërkesat për fshatin Lumadh: 12. Trotuar 1000 metra gjatësi 13. Rregullimi i rrethojës së shkollës e cila ka mbetur në gjysmë, 14. Ura në tri përrockat e fshatit 15. Pastrimi i përronjve 16. Kanalizim 1000 metra gjatësi 17. Kyçja në sistemin e ujit të pijshëm në lagjen “Hetemi” 18. Rrugë për asfaltim 1500 metra gjatësi 19. Një kënd të lodrave tek oborri i shkollës 20. Ura e lumit “Llap” 21. Rrugë të rendit të 4-të 1500 metra gjatësi.	
21	1. Ndërtimi i trotuarit dhe shtegut të biçikletave në rrugën “Sadri Maksuti” 2. Ndërtimi i çerdhes publike në fshatin Stanoc i Poshtëm 3. Ndërtimi i urës tek lagja Duraku 4. Largimi i deponisë së mbeturinave të ngurta 5. Ndërtimi i një fushe të vogël sporti në lagjen e Prekazve 6. Renovimi i trotuarit, rregullimi i kanalizimit atmosferik në rrugën “Fehmi Ademi” 7. Asfaltimi i 34 rrugëve lokale në fshatin Stanoc i Poshtëm 8. Ndërtimi i kanalizimit në 5 lagje 9. Rregullimi i ndriçimit në 3 lagje	Faton Jashari, banor i fshatit Stanoc i Poshtëm

Bashkangjitur me këtë raport mund të gjeni:

1. Njoftimin për mbajtjen e dëgjimit publik
2. Listën e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në dëgjimin publik

Raporti është përgatitur nga:

Mirjeta Duraku-Zyrtare për Informim dhe Monitorim të Mediave





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	196/23
Nr. i fq. / Br. sf	-1-
Data: / Datum	06.09.2023
VUSHTRRI - VUÇITRN	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republik of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri

Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 68.3 të Ligjit nr. 03L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, nenit 61, paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenit 54 të Statutit të Komunës, nenit 6, paragrafi 1.2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, Drejtorinë për Buxhet dhe Financa organizon:

**KONSULTIM PUBLIK
PËR
PROJEKT – BUXHETIN E KOMUNËS SË VUSHTRRIË PËR VITIN 2024 DHE
PARASHIKIMET PËR VITET 2025-2026**

Njoftohen të gjithë qytetarët, grupet e interesit dhe palët tjera të interesuara që të marrin pjesë në konsultimin publik për Projekt – buxhetin e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2024 dhe parashikimet për vitet 2025-2026.

Konsultimi publik do të mbahet më datë **11.09.2023 (e hënë)** në Sallën e Kuvendit, në objektin e Komunës së Vushtrrisë me fillim në ora 11:00.

Ju inkurajojmë të merrni pjesë në takim dhe mirëpresim propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet eventuale gjatë këtij konsultimi publik.

Njëkohësisht, të gjithë qytetarët dhe të interesuarit tjerë në afatin prej 15 ditësh, nga dita e publikimit të këtij njoftimi, të gjitha propozimet, komentet, sugjerimet, vërejtjet mund t'i bëjnë në adresat elektronike: melihate.basholli.latifi@rks-gov.net; mirjeta.duraku@rks-gov.net.

Melihate Basholli - Latifi


Kryesuese e Kuvendit





REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRIË

Lista e pjesëmarrësve

Konsultim publik për Projekt-Buxhetin e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2024 dhe parashikimet për vitet 2025-2026

Vendi: Kuvendi i Komunës

Datë: 11.09.2023

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendi
1	Fatmirë Aliu	Fatmirë Aliu	Begaj
2	Fikrije Ferizi ^{ATO}	Fikrije	Vushtrri
3	Fatije Gërguri	F. Gërguri	Vushtrri
4	Shefkije Muzazi	SH. Muzazi	Begaj
5	Hysni Bekteshi	Hysni	STANOC I ULT C. MADIT
6	Brahim Manoli	B. Manoli	Duboc
7	Fehmi Shala	Fehmi	Stanoc i Gjerë
8	Milashin Hyzeri	Milashin	Shf. "Ali Kelmendi" Vushtrri
9	ARKEN BEHA	Arken	LR. Kercora Vushtrri
10	XHEMAJL BOJKA	Xhemajl	F.SH. DRUPAR
11	Mehmet Ferohi	Mehmet	F.SH. Sponogole
12	Abdullë Kërçan	Abdullë	F.S.H. Zilivodë
13	Hamit Makigj	Hamit	Reznik
14	Sobile BAKA	Sobile	OSHLAN
15	HABIBE JASHARI	Habibe	OSHLAN
16	Sadete Jamuzi	Jamuzi	Vushtrri



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRIË

Lista e pjesëmarrësve

Konsultim publik për Projekt-Buxhetin e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2024 dhe parashikimet për vitet 2025-2026

Vendi: Kuvendi i Komunës

Datë: 11.09.2023

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendi
17	Shemsije Maloku		Vushtrri
18	Vekolone Maloku		Vushtrri
19	Romziq Jekeli		Matinej
20	Sevdije Saoliku		Vushtrri
21	MUHAMET RASHANI		SAMADREXHE
22	LUTKIM SURDULI		SAMADREXHE
23	Artina Llapashtica		Vushtrri
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			